



Në pajtim me nenin 6 paragrafi 1.4,2; nenin 23 paragrafi 1.4.1; nenin 31 paragrafi 1.11; si dhe në pajtim me nenin 23 të ligjit 04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Minierat dhe Mineralet, nenin 38 paragrafi 1.11, nenin 59 paragrafi 1 dhe 62, të ligjit 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me qëllim të rregullimit dhe përcaktimit të rregullave dhe metodave lidhur me caktimin e limiteve të Garancisë Bankare dhe Sigurimin “për të gjitha e rreziqet ndaj palët e treta” në mbledhjen e mbajtur më 14.04.2014 , nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMN NR. 002/2014)

PËR GARANCIONET BANKARE DHE SIGURIMET ” PËR TË GJITHA RREZIQET NDAJ PALËVE TË TRETA”

Neni 1

Qëllimi

1.1. Me anë të këtij udhëzimi rregullohet dhe përcaktohet, vlera dhe mënyra e paraqitjes së Garancionit Bankar për përmbushjen e detyrimeve si dhe Sigurimin “për të gjitha rreziqet ndaj palët e treta”.

1.2. Gjithashtu, me anë të këtij udhëzimi përcaktohen mekanizmat relevant brenda KPMN-së, se si duhet të jenë apo përpunohen Garancionit Bankare për përmbushjen e detyrimeve dhe Sigurimet për të” gjitha rreziqet për palët e treta”.

Neni 2

Paraqitja e Garancive Bankare për përmbushjen e detyrimeve dhe Sigurimi “ për të gjitha rreziqet ndaj palët e treta”

2.1. Çdo Licencë apo Leje lëshohet vetëm pasi që aplikuesi përveç plotësimit të kushteve tjera të përcaktuara me ligj sjell edhe Garancionit Bankare për përmbushjen e detyrimeve si dhe Sigurimin për Rreziqet ndaj palëve të treta, siç është paraparë me ligj dhe me këtë udhëzim administrativ.

2.2. Garancionit Bankare për përmbushjen e detyrimeve duhen të jenë më gjatë se gjashtë (6) muaj se sa afati i Licencës apo Lejës.

2.3 Sigurimi “për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta” paraqitet për tërë afatin kohëzgjatja e Licencës apo Lejës.

Neni 3

Forma e garancive për përmbushjen e detyrimeve tek licencat e Hulumtimit, Shfrytëzimit dhe Lejet për Aktivitet e Veçanta

3.1. Formën e garancinë për përmbushjen e detyrimeve dhe sigurimin për “të gjitha rreziqet” ndaj palëve të treta e përcakton KPMM, MMPH, APK dhe Ministria në pajtim me nenin 23 paragrafi 1.4.1; nenin 31 paragrafi 1.11 dhe në pajtim me nenin 23 të ligjit 04/L-158, për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit për Minierat dhe Minerale; nenin 38 paragrafi 1.11 të ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale.

3.2. Garancisë Bankare apo e letrës me vlerë e investimeve të korporatës ose Qeveritare , Euro-Obligacione dorëzohen në KPMM, pastaj KPMM i dërgon njëerës Bankë të licencuar në Kosovë nga Banka Qendrore e Kosovës.

3.3 Rishikimi dhe rikalkulimi, sipas nevojës, i kostove të lidhura me mbylljen e aprovuar të minierës dhe detyrimin e rehabilitimit do të kryhet sipas nevojës por së paku një herë çdo tri (3) vite kalendarike nga KPMM në pajtim me kërkesat e nenit 31.11 te Ligjit bazik

3.4. Deri në deponimin e plotë të garancisë sipas nën paragrafit 1.11.2, të këtij neni bartësi i licencës deponon një pjesë të garancisë në shumën e përcaktuar nga KPMM në baza tremujore.

3.5. Mjetet e paguara si garancion për rehabilitim i kthehen kompanisë pas përfundimit të rehabilitimit në përputhje me projektet e aprovuara nga KPMM, MMPH, APK.

3.3. Në kuptim të çështjes së shfrytëzimit të mineraleve forma e garancisë ka për qëllim parashikimin e KPMM-së, sa i përket kostos inxhinierike për të rehabilituar lokacionin në pajtim me planin e miratuar për mbylljen e minierës dhe rehabilitimin e saj. Parashikimi nga ky paragraf përveç KPMM-së bëhet edhe në bashkëpunim me MMPH-ën, APK dhe MZHE .

Neni 4

Forma e Sigurimit ” për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta “

4.1. Përcaktimi i limiteve për sigurimin “për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta” tek Licencat e Hulumtimit:

4.1.1. Licencat e Hulumtimit për Minerale Metalore dhe Energjetike 50,000.00€

4.1.2. Licencat e Hulumtimit për Minerale tjera 20,000.00 €

4.2. Përcaktimi i limiteve për sigurimin” për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta”, tek Licencat e Shfrytëzimit, të mineraleve metalore.

- 4.2.1. Viti i parë i prodhimit minimumi 200,000.00 €
- 4.2.2. Viti i dytë i prodhimit minimumi 200,000.00 €
- 4.2.3. Viti i tretë i prodhimit minimumi 400,000.00 €
- 4.2.4. Viti i katërt i prodhimit minimumi 400,000.00 €
- 4.2.5. Nga viti i pestë e tutje minimumi 700,000.00 €

4.3. Përcaktimi i limiteve për sigurimin “për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta” tek Licencat e Shfrytëzimit të mineraleve energjetike.

- 4.3.1. Licencat për shfrytëzim të Mineraleve Energjetike 1,500,000.00 €

4.4. Përcaktimi i limiteve për sigurimin “ për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta”, tek Licencat e Shfrytëzimit të mineraleve të tjera

- 4.4.1. Licencat për Shfrytëzim me përdorim të eksplozivit 150,000.00 €.
- 4.4.2. Licencat për Shfrytëzim pa përdorim të eksplozivit 50,000.00 €.

4.5. Përcaktimi i limiteve për sigurimin” për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta” tek Lejet për Aktivitete të Veçanta

- 4.5.1. Bazë Betoni minimumi 70,000.00 €
- 4.5.2. Bazë Asfalti minimumi 70,000.00 €
- 4.5.3. Seperacion minimumi 70,000.00 €
- 4.5.4. Flotacion apo nyje e xehe minimumi 100,000€

Neni 5

Për të gjitha ngastrat ose vendshfrytëzimet për mineralet e caktuar ku kërkohej rikultivim, garancit bankare ose bondet për rikultivim janë si më poshtë:

5.1. Për të gjitha kërkesat për licenca të shfrytëzimit të mineraleve ndërtimore shuma për garancionin bankar është si në vijim:

- 5.1.1. Garanci Bankare ose bondet për rikultivim për Siperfaqen 0-1 hektar shuma 5000.00 €
- 5.1.2. Garanci Bankare ose bondet për rikultivim për Siperfaqja 1-2 hektar shumën 10,000.00 €.

5.1.3 Garanci Bankare ose bondet per rikultivim per Siperfaqen prej 1-3 hektar shumen 15,000.00 €.

5.1.4 Cdo rritje te siperfaqes per hektar vlene rritja plus Garanci Bankare ose bondet per rikultivim per shumen 5000.00 €.

5.1.5 Licencat e shfrytezimit te mineraleve ndertimore pa minim- Garanci Bankare ose pagesa e bondit per shumen 12,000.00 € për hektar.

5.1.6 Licencat e shfrytezimit te mineraleve industriale Garanci Bankare ose pagesa e bondit per shumen 12,000.00 € për hektar.

5.2 Licencat e shfrytezimit te mineraleve metalore ne minierat siperfaqesore Garanci Bankare ose pagesa e bondit per shumen 12,000.00 € për hektar.

5.3 Licencat e shfrytezimit te mineraleve energjetike ne minierat siperfaqesore Garanci Bankare ose pagesa e bondit per shumen 12,000.00 € për hektar.

Neni 6

Plani i Mbylljes së Minierës

6.1 Tre (3) muaj para skadimit të afatit të licencës Komisioni i përbërë nga institucionet e parapara si në nenin 3 paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ shqyrton kërkesën e kompanisë për rimbursim dhe do të vlerësoj situatën në teren dhe do të dorëzoj raportin tek Bordi i KPMM. Nëse raporti është pozitiv atëherë KPMM-ja ja kthen letrën me vlerë të performancës apo fondet në bankë të licencuarit.

6.2. Nëse raporti është negativ që i bie që kompania nuk ka përfunduar rehabilitimin në pajtim me planin për mbyllje dhe rehabilitim të mihjës, atëherë do të inkasohet letra me vlerë ose fondet do të kërkohen nga banka e aprovuar që t'i jepen KPMM-së për të proceduar me rehabilitim. Toka e rehabilituar do të bëhet pronë e Republikës së Kosovës përveç kur pronësia është siguruar nga pronarët privat gjatë periudhës së licencës së mihjës.

6.3. Bordi i KPMM-së është i obliguar të merr një vendim brenda 30 ditëve për të inkasuar fondet e depozituar për rehabilitim.

Neni 7

Procedura e përpunimit në KPMM

7.1. Pas aprovimit të aplikacionit për licencë apo leje nga Bordi i KPMM-së aplikuesi duhet të sjellë në KPMM brenda 15 ditë nga data e pranimit të aktvendimit për miratimin e çdo licence për Hulumtim, Shfrytëzim dhe për Leje për Aktivitete të Veçanta Garancinë për përbushjen e detyrimeve dhe sigurimi “për të gjitha rreziqet ndaj palëve të treta “

7.2 Asnjë licencë apo leje nuk mund të lëshohet pa këto dokumente siç janë të përcaktuar në nenin 7 paragrafi 1.

7.3 Pas miratimit të licencës apo lejes nga Bordi i KPMM-së dhe përmbushjes së kushteve për të sjell dokumentet e parapara në nenin 3 paragrafi 1 të këtij udhëzimi, Departamenti i Financave në KPMM, përgatitë një raport lidhur me dokumentet e paraqitur nga aplikuesi. Raporti përgatitet brenda 2 ditë pune nga skenimi i dokumenteve apo Protokollimi i tyre.

7.4 Raporti duhet të përmbaj të dhënat se a është në pajtim me projektet dhe sipërfaqen e miratuar nga Bordi i KPMM-së, se dokumentet a janë lëshuar nga organi kompetent, se a janë lëshur në pajtim me ligjin në fuqi dhe të dhënat tjera me rëndësi.

Neni 8

Dispozitat kalimtare

8.1 Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

8.2 Me këtë Udhëzim administrativ shfuqizohet vendimi i Bordit i datës 15.03.2011



Ramiz Krasniqi
UD. Kryesuesit te Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale